



**KOMUNA VUSHTRRI**

**BALETI KOMBËTAR I KOSOVËS**

## **MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT**

Në mes të :

- Komunës së Vushtrrisë të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ferit Idrizi.(në tekstin e mëtejme Komuna),dhe
- Baletit Kombëtar të Kosovës ,të cilin e përfaqëson z.Sinan Kajtazi, Drejtor i Baletit (në tekstin e mëtejme Baleti Kombëtar).

### **Neni 1**

#### **Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi i Komunës së Vushtrrisë me Baletin Kombëtar të Kosovës për sigurimin e një Balerini/e, i/e cili/a do të mbaj orë trajnimi për fëmijët (e Komunës së Vushtrrisë nga 4 vjeç deri në 12 vjeç në Balet në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

### **Neni 2**

#### **Obligimet e palëve**

##### **2.1 Obligimet e Komunës së Vushtrrisë**

2.1.1.Komuna do ta bëjë sigurimin e hapësirës dhe të gjitha shpenzimeve tjera të nevojshme si: energjia elektrike, ngrohja, ventilimi dhe mjete logjistike.

2.1.2.Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të bëjë regjistrimin e nxënësve dhe përcjelljen e mbarëvajtjes së orëve.

##### **2.2. Obligimet e Baletit Kombëtar të Kosovës**

2.2.1.Baleti Kombëtar i Kosovës do të na siguroj një balerin/ë profesionist/e i/e cili/a do të mbajë mësimet baleti për fëmijët nga 4 vjeç deri në 12 vjeç.

**Neni 3**  
**Kushtet e pagesës së balerinës/it**

- 3.1. Pagesa e balerinës/it profesionist/e do të bëhet me participim të fëmijëve si në vijim;
- 3.1.1. Pagesa për një fëmijë është 10 (dhjetë) euro për një muaj në llogari të balerinës/it;
- 3.1.2. Çdo i treti fëmijë i një familjeje lirohet nga pagesa.
- 3.1.3. Për fëmijët që janë binjak ka lirim 25% (që i bie për të dy fëmijët 15 pesëmbëdhjetë euro).
- 3.1.4. Nga pagesa lirohen të gjithë fëmijët që kanë aftësi të kufizuara dhe fëmijët e familjeve të cilët jetojnë me asistencë sociale.

**Neni 4**  
**Mbarëvajtja e orëve**

- 4.1. Në një orë baleti e cila zgjat 50 minuta nuk lejohet të ketë më shumë se 20 – 25 (njëzet deri në njëzet e pesë) fëmijë.
- 4.2. Ushtrimet do të mbahen dy herë brenda javës për secilin grup të fëmijëve.
- 4.3. Në rast të numrit të madh të fëmijëve dhe formimit të shumë klasëve, Baleti Kombëtar i Kosovës do të siguroj një tjetër balerin/ë profesionist/e për mbajtjen e orëve.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

- 5.1. Kjo marrëveshje zgjat në afat prej 1 (një) viti, me mundësi vazhdimi.

**Neni 6**  
**Mbikëqyrja**

- 6.1. Mbikëqyrja për zbatimin e marrëveshjes bëhet nga Drejtori i Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina".

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit është përpiluar në një ekzemplar për secilën palë dhe do të hyj në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Palët nënshkruese,**

**Baleti Kombëtar i Kosovës**

  
-----  
**Sinan Kajtazi, Drejtor**

**Komuna e Vushtrrisë**



-----  
**Ferit Idrizi, Kryetar**